

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

dhe rrezikun e likuiditetit. Funkzioni kryesor i menaxhimit të rrezikut financiar është të vendosë kufij të rrezikut dhe të sigurojë që çdo ekspozim ndaj rrezikut të mbetet brenda këtyre kufijve. Shoqëria mbështetet në programin global të menaxhimit të rrezikut, të grupit dhe menaxhimi i përgjithshëm i rrezikut në lidhje me këto rreziqe kryhet nga departamenti i financave dhe administratës së Shoqërisë në bashkëpunim me funksionet përkatëse globale.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria blen cigare për rishitje nga furnizues të huaj dhe shlyen detyrimet e saj në euro. Të ardhurat nga shitja janë realizuar në tregun e brendshëm në Lek. Gjithashtu, shoqëria merr pjesë në transaksione ndërkombëtare dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutor që rrjedh nga ekspozimi i monedhës vendase ndaj luhatjeve të monedhës së huaj, kryesisht euro dhe franga zvicerane.

Shoqëria përdor funksionin e thesarit në grup për të mbuluar rrezikun që lindë nga transaksionet tregtare të shprehura në monedhë që nuk është monedha që përdor Shoqëria.

Përqendrimi kryesor i shoqërisë ndaj rrezikut të këmbimit valutor është drejt euro dhe franges zvicerane. Shoqëria nuk përdor instrumente derivative për tu mbrojtur nga ekspozimet kundrejt rrezikut të këmbimit valutor.

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të këmbimit valutor është si vijon

Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)**31 dhjetor 2022**

	EUR	USD	CHF	GBP	LEK	Total
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	-	-	-	-	916,961	916,961
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	197	197
	-	-	-	-	917,158	917,158
Llogari të pagueshme	1,004,934	9,972	10,294	1,634	358,367	1,385,201
Detyrime per qiranë	98,304				7,399	105,703
	1,103,238	9,972	10,294	1,634	365,766	1,490,904
Ekspozimi valutor më 31 dhjetor 2022	(1,103,238)	(9,972)	(10,294)	(1,634)	551,392	(573,746)

31 dhjetor 2021

	EUR	USD	CHF	GBP	LEK	Total
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	-	-	-	-	719,110	719,110
Llogari të arkëtueshme	155,667	-	-	-	31	155,698
	155,667	-	-	-	719,141	874,808
Llogari të pagueshme	860,445	6,230	4,936	9,051	288,441	1,169,101
Detyrime per qiranë	88,280	-	-	-	19,592	107,872
	948,725	6,230	4,936	9,051	308,033	1,276,973
Ekspozimi valutor më 31 dhjetor 2021	(793,058)	(6,230)	(4,936)	(9,051)	411,108	(402,165)

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

7. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Kursët zyrtarë të këmbimit për monedhat e huaja kryesore të aplikuar gjatë vitit:

LEKË	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2022	2021	2022	2021
USD	113.00	103.52	107.05	106.54
EUR	118.83	122.46	114.23	120.76
CHF	118.50	113.29	116.13	116.82
GBP	139.75	142.42	128.92	143.95

Analiza e ndjeshmërisë

Duke marrë parasysh zhvlerësimin e Lekut Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në të ardhurat e saj. Në perspektivën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në kursët e këmbimit të monedhave të huaja dhe normave të interesit mund të kenë ndikim në fitim.

Më 31 dhjetor 2022, nëqoftëse Leku do të kishte pësuar ngritje/ulje mesatarisht +/- 5% përkundrejt Euro-s, duke marrë parasysh se të gjithë faktorët e tjerë do të jenë konstant, fitimi pas tatimit për vitin do të kishte qënë LEK 55,162 më e ulët/lartë (2021: fitimi për vitin do të kishte qënë LEK 39,653 mijë më i lartë/ulët), kryesisht si rezultat i humbjes/fitimit nga shkëmbimi në monedhat e huaja si Euro të dominuara nga huatë dhe llogaritë e pagueshme.

Rreziku i normës së interesit

Shoqëria ekspozohet ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut si ndaj vlerës së drejtë ashtu dhe ndaj rrezikut të rrjedhës së parasë. Marzhet e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të ulë humbjet në rast ndryshimesh të papritura. Drejtimi monitoron çdo ditë dhe vendos kufij në nivelin e mospërputhjes së rivlerësimit të çmimit të normës së interesit që mund të ndërmerret.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e vlerës së drejtë të Shoqërisë ndaj rrezikut të normës së interesit. Ajo përfshin instrumente financiare të Shoqërisë me vlerat e mbetura të kategorizuara nga rivlerësimi më i hershëm.

	Deri në 3 muaj	Midis 3 dhe 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Totali
31 dhjetor 2022					
Aktive financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	916,961	-	-	-	916,961
Llogaritë të arkëtueshme	-	-	-	197	197
Totali aktiveve financiare	916,961	-	-	197	917,158
Detyrimet financiare					
Detyrime për qiranë	10,267	34,073	61,363	-	105,703
Llogari të pagueshme	-	-	-	1,385,201	1,385,201
Totali detyrimeve financiare	10,267	34,073	61,363	1,385,201	1,490,904
Ekspozimi nga rivlerësimi i interesit	906,694	(34,073)	(61,363)	(1,385,004)	(573,746)

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKE, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

7. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

	Deri në 3 muaj	Midis 3 dhe 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Totali
31 dhjetor 2021					
Aktive financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	719,110	-	-	-	719,110
Llogaritë të arkëtueshme	-	-	-	155,698	155,698
Totali aktiveve financiare	719,110	-	-	155,698	874,808
Detyrimet financiare					
Llogari të pagueshme	7,934	23,800	76,138	-	107,872
Detyrime per qiranë	-	-	-	1,169,102	1,169,102
Totali detyrimeve financiare	7,934	23,800	76,138	1,169,102	1,276,974
Ekspozimi nga rivlerësimi i interesit	711,176	(23,800)	(76,138)	(1,013,404)	(402,166)

Shoqëria nuk ka asnjë aktiv ose detyrim me vlerë të drejtë që mbart normë fikse interesi dhe si rrjedhojë nuk njuh asnjë humbje ose fitim, gjithashtu Shoqëria nuk përdor asnjë derivat. Për këtë arsye, një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikojë në fitimin ose humbjen.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare për Shoqërinë, nëse një klient ose pala e lidhur nga një instrument financiar nuk arrijnë të përmbushin detyrimet kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë nga klientët.

Rreziku i kredisë vjen edhe nga mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre si dhe ekspozimet e kreditit ndaj klientit, duke përfshirë arkëtimet dhe transaksionet e kryera të pashlyera në rastin kur klienti i tij kryesor nuk ka aftësinë për të përmbushur detyrimet e tij.

Shoqëria ka vetëm një klient i cili ka si afat pagese prej 8 ditë/30 ditë, prandaj Shoqëria nuk ka rrezik përqëndrimi të rëndësishëm të kredisë

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktivitet financiare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	916,961	719,110
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	197	155,698
Totali	917,158	874,808

Rreziku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i rrezikut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parave të disponueshme në mënyrë që të përmbushen të gjitha detyrimet financiare në kohë. Departamenti i financave rregullisht monitoron burimet e disponueshme të parave dhe ka një fokus të fortë në rrjedhën e parave duke përditësuar parashikimet ditore dhe mujore.

Tabela e mëposhtme analizon detyrimet financiare të shoqërisë në grupime sipas maturimit përkatës të bazuar në periudhën e mbetur në pasqyrën e pozicionit financiar deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat e paraqitura në tabelë janë flukse monetare të parasë të pa skontuara. Shumat që janë për tu paguar brend 12 muajve janë të barabartë me vlerën e tyre historike sepse impakti i skontimit nuk është material.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

7. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

31 dhjetor 2022	Deri në 3 muaj	3-12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	916,961	-	-	916,961
Llogari të arkëtueshme	197	-	-	197
Totali aktiveve financiare	917,158	-	-	917,158
Detyrime financiare				
Detyrime per qiranë	10,267	34,073	61,363	105,703
Llogari të pagueshme	1,344,834	40,367	-	1,385,201
Totali detyrimeve financiare	1,355,101	74,440	61,363	1,490,904
Ekspozimi i parregulluar i aktiveve dhe detyrimeve	(437,943)	(74,440)	(61,363)	(573,746)
	Deri në 3 muaj	3-12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Totali
31 dhjetor 2021				
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	719,110	-	-	719,110
Llogari të arkëtueshme	155,698	-	-	155,698
Totali aktiveve financiare	874,808	-	-	874,808
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	7,934	23,800	76,138	107,872
Detyrime per qiranë	918,215	250,887	-	1,169,102
Totali detyrimeve financiare	926,149	274,687	76,138	1,276,974
Ekspozimi i parregulluar i aktiveve dhe detyrimeve	(51,341)	(274,687)	(76,138)	(402,166)

Edhe pse ekspozimi i likuiditetit është negativ, shumica e llogarive të pagueshme me maturitet 90 ditë lidhen me Philip Morris Product Tolling SA, një shoqëri grupi-palë e lidhur.

Një linjë kredie në vlerë prej 100 milionë lekë (2021: 100 milionë lekë) është në dispozicion me Intesa San Paolo Bank Albania me normë të veçantë të interesit në indeksin e bonove të thesarit 6-mujore plus 100 bps, e cila nuk është përdorur gjatë vitit 2022. Shoqëria rinovon kredinë çdo vit, marrëveshja aktuale skadon në tetor 2023.

8. Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë gjatë menaxhimit të kapitalit janë:

Të ruajnë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, në mënyrë që të sigurojë kthimin e kapitalit për pronarët dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit dhe për të ulur koston e kapitalit

Totali i kapitalit është llogaritur si "kapital" siç tregohet në bilanc plus borxhin neto.

Me qëllim mbajtjen dhe korigjimin e struktues së kapitalit shoqëria mund të ndryshoj shumën e fitimit që i shperndahet aksionereve, shpërndarjen e kapitalit tek aksioneret, shtimin e kapitalit ose shitjen e aktiveve për të ulur borxhet.

Shoqëria nuk ka hua afatgjata.

Shoqëria nuk është institucion financiar dhe si rrjedhojë nuk është e detyruar të jetë në pajtueshmeri me asnjë kërkesë mbi kapitalin të vendosura nga rregullatorët.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

9. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Mobilje	Mjete transporti	Pajisje elektronike	Përmirësime të ndërtesës	Aktive në proces	Makineri	Totali
Më 1 janar 2021	192,914	14,674	68,569	10,001	11,018	2,230	299,406
Shtesa	30,551	-	-	-	76	-	30,627
Pakësime	(53,379)	(2,658)	(419)	-	-	-	(56,456)
Transferime	-	-	11,094	-	(11,094)	-	-
Më 31 dhjetor 2021	170,086	12,016	79,244	10,001	-	2,230	273,577
Shtesa	24,408	-	667	-	4,164	-	29,239
Pakësime	(50,376)	(7,060)	(770)	-	-	-	(58,206)
Transferime	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	144,118	4,956	79,141	10,001	4,164	2,230	244,610
Zhvierësimi akumuluar							
Më 1 janar 2021	(145,127)	(14,674)	(34,160)	(9,471)	-	(334)	(203,766)
Shpenzimi i vitit	(21,774)	-	(21,769)	(530)	-	(446)	(44,519)
Pakësimet	48,506	2,658	328	-	-	-	51,492
Më 31 dhjetor 2021	(118,395)	(12,016)	(55,601)	(10,001)	-	(780)	(196,793)
Shpenzimi i vitit	(19,472)	-	(20,410)	-	-	(446)	(40,328)
Pakësime	38,271	7,060	630	-	-	-	45,961
Më 31 dhjetor 2022	(99,596)	(4,956)	(75,381)	(10,001)	-	(1,226)	(191,160)
Vlera Kontabël Neto							
Më 31 dhjetor 2021	51,691	-	23,643	-	-	1,450	76,784
Më 31 dhjetor 2022	44,522	-	3,760	-	4,164	1,004	53,450

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

10. Aktive me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë

Shoqëria ka marrë me qira aktive të ndryshme për shembull: ndërtesë, magazinë, mjete transporti dhe shtëpi për punonjësit e huaj të ardhur me detyrë afatshkurtër. Kontratat e qirasë janë zakonisht për periudha fikse midis 1 dhe 5 vjet por mund të kenë mundësinë e rinovimit, si më poshtë..

Pasqyra e pozicionit financiar tregon shumat e mëposhtme në lidhje me qiranë.

Aktive me të drejtë përdorimi

	Ndërtesa	Transport	Të tjera	Totali
Më 1 janar 2021	71,572	67,465	7,480	146,517
Shtesa	31,668	-	-	31,668
Pakësime	-	(3,026)	(2,408)	(5,434)
31 dhjetor 2021	103,240	64,439	5,072	172,751
Shtesa	1,328	37,506	-	38,834
Pakësime	-	(1,003)	-	(1,003)
31 dhjetor 2022	104,568	100,942	5,072	210,582
Amortizim i akumuluar				
1 janar 2021	(21,665)	(12,778)	(6,238)	(40,681)
Shpenzimi i amortizimit	(20,008)	(14,293)	(201)	(34,502)
Të tjera	-	-	1,367	1,367
31 dhjetor 2021	(41,673)	(27,071)	(5,072)	(73,816)
Shpenzimi i amortizimit	(22,324)	(18,343)	-	(40,667)
Të tjera	-	-	-	-
31 dhjetor 2022	(63,997)	(45,414)	(5,072)	(114,483)
Vlera kontabël neto më 1 janar 2022	61,567	37,368	-	98,935
Vlera kontabël neto më 31 dhjetor 2022	40,571	55,528	-	96,099

Shoqëria ka njohur detyrime për qiranë si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrime afatgjatë për qiranë	61,363	70,237
Detyrime afatshkurtër për qiranë	44,340	37,635
Totali i detyrimeve për qiranë	105,703	107,872

Shpenzimet e interesit të përfshira në kostot financiare të 2022 ishin 8,584 mijë lekë (2021: 8,579 mijë lekë).

Shpenzimet e lidhura me qiratë afatshkurtër (të përfshira në shpenzimet administrative) dhe të qirave për aktivet me një vlerë të ulët të cilat nuk janë të paraqitura tek kategoria e qirave afatshkurtër:

	2022	2021
Shpenzime për qiratë afatshkurtër	402	2,826
Shpenzime për qiranë e aktiveve me vlerë të ulët që nuk janë paraqitur më sipër	-	329

Totali i pagesave të bëra për qiratë në 2022 ishte 45,859 mijë lekë (2021: 44,814 mijë lekë).

Marrëveshja e qirasë nuk imponon ndonjë marrëveshje tjetër përveç sigurimit të interesave për aktivet që mbahen nga qiradhënësi. Aktivet e marra me qira nuk mund të përdoren si kolateral për hua.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

11. Rakordimi i detyrimeve të ngritura nga aktivitetet financiare

Tabela më poshtë përcakton një analizë të detyrimeve nga aktivitetet e financimit dhe lëvizjeve në detyrimet e Shoqërisë nga aktivitetet e financimit për secilën nga periudhat e paraqitura. Artikujt e këtyre detyrimeve janë ato që raportohen si financim në pasqyrën e flukseve të parasë:

	31 dhjetor 2022			31 dhjetor 2021		
	Detyrime të qirasë	Dividend i pagueshëm	Totali	Detyrime të qirasë	Dividend i pagueshëm	Totali
Detyrime nga veprimatritë financiare më 1 janar	107,872	-	107,872	116,249	-	116,249
<i>Flukset e parasë</i>						
Ripagimet e detyrimeve të qirasë	(45,859)	-	(45,859)	(44,814)	-	(44,814)
Dividendi i paguar	-	(186,432)	(186,432)	-	(98,074)	(98,074)
<i>Ndryshime jo-monetare</i>						
Shpërndarje dividendi	-	186,432	186,432	-	98,074	98,074
Shpenzim interesi	8,584	-	8,584	8,579	-	8,579
Qira të reja	38,834	-	38,834	31,668	-	31,668
Qira të përfunduara	(1,003)	-	(1,003)	(3,263)	-	(3,263)
Efekt kursit të këmbimit	(2,725)	-	(2,725)	(547)	-	(547)
Detyrime nga veprimtaritë financiare më 31 dhjetor	105,703	-	105,703	107,872	-	107,872

12. Inventari

Inventari përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Produkt i gatshëm	3,427,508	2,305,814
Zhvlerësim Inventari	(2,001)	-
Totali	3,425,507	2,305,814

13. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme përshkruhen në tabelën në vijim:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të arkëtueshme nga klientë tjerë	197	31
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	-	155,667
Totali	197	155,698

Asnjë zhvlerësim për të arkëtueshmet nuk është llogaritur në 31 dhjetor 2022 dhe 2021. Të gjitha balancat janë brenda afateve të tyre të pagesës. Maturimi i të arkëtueshmeve tregtare analizohet si më poshtë:

	Balanca	%	Zhvlerësimi	Vlera neto
31 dhjetor 2022				
0-30 ditë	197	0%	-	197
31 dhjetor 2021				
0-30 ditë	155,698	0%	-	155,698

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

13. Llogari të arkëtueshme (vazhdim)

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rreziqeve të kredisë dhe monedhës dhe humbjet nga zhvlerësimi në lidhje me të arkëtueshmet tregtare janë dhënë në shënimin 7.

14. Aktive të tjera

Aktivitetet e tjera përshkruhen në tabelën në vijim:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime për furnitorët	52,505	29,009
Taksë akcize e arkëtueshme	11,231	11,232
Parapagime të tjera	2,763	1,517
Totali	66,499	41,758

Vlera e akcizës për t'u rimbursuar i përket pjesës së mallrave të cilat janë shkatërruar, rimbursimi për të cilat do të bëhet nga autoritetet tatimore. Shoqëria është e bindur se do të rimbursohet për gjithë vlerën e akcizës meqënëse ajo lidhet me mallrat për t'u shkatërruar për të cilat është ndjekur procedura sipas ligjeve në fuqi.

15. Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendja në bankë		
Në monedhën vendase	916,961	719,110
Totali	916,961	719,110

Mjetet monetare në bankë janë mbajtur në banka me renditje AA-. Ekspozimi i shoqërisë ndaj këmbimit valutor është paraqitur në shënimin shpjegues 7.

16. Kapitali aksionar

	Numri i aksione të zakonshme	Vlera në LEKË
Më 31 dhjetor 2021	1,000	29,000
Më 31 dhjetor 2022	1,000	29,000

Kapitali aksionar i Shoqërisë zotërohet plotësisht 100% nga Philip Morris Switzerland Sarl. Shoqëria mëmë është Philip Morris International Inc.

Pagesat e bazuara në aksione. Shoqëria operon me një numër të planeve të kompensimit të bazuara në aksione të rregulluara me kapital neto, sipas të cilave njësisia ekonomike merr shërbime nga punonjësit si shpërblim për aksionet në kapitalin e Shoqërisë. Punonjësit e kualifikuar marrin kompensime afatgjata të kapitalit që dorëzojnë aksionet e PMI pas një periudhe shërbimi trevjeçare.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

17. Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera

Furnitorë dhe detyrime të tjera janë analizuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
<i>Detyrime financiare</i>		
Llogari të pagueshme tregtare	139,036	82,408
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura (shënimi 26)	963,016	789,672
Shpenzime të tjera të përlogaritura	283,149	297,022
	<u>1,385,201</u>	<u>1,169,102</u>
<i>Detyrime jo - financiare</i>		
Taksat dhe detyrime të tjera	18,255	20,621
Detyrimi tatimor i akcizës	2,865,133	1,810,676
Detyrimi tatimor i TVSH	23,162	53,265
	<u>2,906,550</u>	<u>1,884,562</u>
Totali	<u>4,291,751</u>	<u>3,053,664</u>

Detyrimet ndaj palëve të lidhura përbëhen kryesisht nga detyrimet ndaj Philip Morris Product SA për blerjen e produktit të gatshëm nga fabrikat e prodhimit, të cilat nuk janë paguar në fund të vitit. Termat e pagesës janë brenda 90 ditëve.

Llogaritë e pagueshme për palët e lidhura janë paraqitur në shënimin shpjegues 26. Ekspozimi i Shoqërisë për likuiditetet dhe rrezikut nga këmbimi valutë që dalin nga llogaritë e pagueshme janë paraqitur në shënimin shpjegues 7.

Shpenzimet të tjera të përlogaritura përfshijnë kryesisht shpenzime të marketingut dhe kosto të shitjeve si dhe shpenzime administrative.

18. Të ardhura nga kontrata me klientë

Të ardhurat të paraqitura në pasqyrat e të ardhurave janë analizuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Të ardhura neto nga shitjet e mallrave	13,584,176	11,324,837
Totali	<u>13,584,176</u>	<u>11,324,837</u>

Shitjet janë paraqitur në vlerën neto duke zbritur kompensimin tregtar dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, por bruto për sa i përket akcizës. Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, zbritjet ndaj klientëve ishin 364,651 mijë lekë (2021: 328,799 mijë lekë). Të ardhurat për të gjitha shitjet njihen në momentin kohor kur mallrat i dorëzohen klientit.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

19. Kosto e mallrave të shitur

Shpenzimet e mallrave të shitura, të paraqitura në pasqyrat e të ardhurave janë analizuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Kosto e mallrave të shitur	12,434,973	10,250,149
Totali	12,434,973	10,250,149

Kosto e mallrave të shitura përfshin koston e mallrave (koston e blerjes), taksën e akcizës dhe kosto dhe tarifa të tjera të përkuperueshme të lidhura me blerjet.

20. Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime të shitjes dhe distribucionit	590,226	574,591
Shpenzime administrative	397,718	353,450
Totali	987,944	928,041

Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative janë të analizuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime për komunikim	392,031	369,382
Kosto personeli	173,286	148,903
Shpenzime/kompensime brenda grupit	165,372	142,748
Të tjera	97,538	96,462
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	40,328	44,519
Shpenzime amortizimi qiratë	40,666	34,502
Mirëmbajtje dhe riparime PPOSM	33,357	20,865
Kërkim e studim tregu	17,562	43,899
Shpenzime për automjetet e Shoqërisë	13,027	11,532
Telefone/celular/shpenzime interneti	4,181	4,239
Shpenzime akomodimi	4,027	2,783
Shpenzime ligjore	3,872	6,098
Shpenzime transporti	2,294	728
Shpenzime të tjera qiraje	403	1,381
Totali	987,944	928,041

Shpenzimet brenda grupit kanë të bëjnë me shërbime të përgjithshme të përbashkëta nga palët e lidhura, përfshirë financën, burimet njerëzore, telekomunikacionin, shërbimet e infrastrukturës IT.

Shpenzimet e personelit të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Paga dhe përfitime të tjera të punonjësve	158,762	135,799
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	14,524	13,104
Totali	173,286	148,903

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

20 Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative (vazhdim)

Shpenzime të tjera janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Shërbime konsulence	24,729	40,002
Të tjera	18,375	22,165
Kontribute për bamirësi	13,312	1,322
Shpenzime të tjera për punonjësit	11,592	11,260
Shpenzime për mbledhje dhe konferenca	9,547	3,905
Shpenzime për udhëtime	5,688	4,656
Antarësime	4,537	2,650
Ujë/drita dhe pastrim	4,313	3,733
Mostra për analiza cigaresh	3,880	3,439
Shpenzime sigurimi	1,565	3,330
Totali	97,538	96,462

Kontributete e bamirësisë në vitin 2022, lidhen me « Programin e Riciklimit të Mbetjeve Urbane » ku në bashkëpunim me institucione publike dhe private kanë si qëllim informimin, edukimin dhe angazhimin e të rinjve dhe institucioneve publike në çeshtjet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta duke promovuar mbrojtjen e mjedisit, shendetin publik dhe sostenibilitetin. Kontributet e bamirësisë në vitin 2021 kanë të bëjnë me një hapësirë të gjelbër të dhuruar Bashkisë së Tiranës, prane parkut kombëtar të liqenit.

21. Të ardhura/shpenzime të tjera

Të ardhura të tjera janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të ardhura të tjera	1,868	761
Tarifat e shërbimit- palët e lidhura	-	156,123
Totali	1,868	156,884

Të ardhurat e tjera i referohen kryesisht të ardhurave nga transaksionet e shitjes së aktiveve të kompanisë. Tarifat e shërbimit përfshijnë tarifën e marra nga Philip Morris Products S.A për shpërndarjen e produkteve me rrezik të reduktuar.

Shpenzime të tjera janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të tjera	13,442	50,416
Shpenzime për detyrime tatimore	-	5,079
Totali	13,442	55,495

22. Fitime nga kursi i këmbimit

Diferencat nga kursi i këmbimit të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Humbjet nga transaksionet e këmbimit valutor	(35,977)	(12,319)
Fitimet nga transaksionet e këmbimit valutor	94,759	27,700
Fitim/ (humbje) nga kursi i këmbimit, neto	58,782	15,381

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

23. Kosto financiare

Kostot financiare të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Shpenzime për interesa mbi lehtësitë bankare	(11,430)	(11,420)
Shpenzime për interesa mbi qiratë	(8,584)	(8,579)
Të ardhurat nga interesi në llogaritë rrjedhëse	2,150	-
Totali	(17,864)	(19,999)

24. Tatimi mbi fitimin

Detyrimi tatimor për vitin është paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Tatim fitimi aktual	37,646	56,769
Tatim fitim i viteveve të mëparshme	718	111
Tatimi i shtyrë	(2,136)	79
Totali	36,228	56,986

Norma e tatimit mbi të ardhurat e zbatueshme në të ardhurat e Shoqërisë në 2022 është 15% (2021: 15%).

Shpenzimi për vitin, mund të rakordohet me fitimin e paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	190,603	243,418
Tatim fitimi i përlogaritur (15%)	28,591	36,513
Shpenzime të pazbritshme	9,055	20,283
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	37,646	56,796

Pozicionet e pasigurta të taksave të Shoqërisë rivlerësohen nga menaxhmenti në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat që përcaktohen nga Drejtimi si më shumë të ngjarë të mos rezultojnë në mbledhjen e taksave shtesë nëse pozicionet do të sfidohen nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose miratuar në mënyrë thelbësore deri në fund të periudhës së raportimit, dhe çdo gjykatë të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjokat, interesat dhe taksat përveç atyre mbi të ardhurat njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit për shpenzimet e kërkuara për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Aktivitet tatimore të shtyra janë klasifikuar për shkak të diferencave të përkohshme që lindin midis vlerës së tatueshme dhe vlerës kontabël të aktiveve të Shoqërisë. Lëvizja në aktivet tatimore të shtyra analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Në fillim të vitit	8,789	8,721
<i>Efekt në aktivet afatgjata materiale</i>	<i>1,832</i>	<i>(56)</i>
<i>Efekt në aktive/detyrime me të drejtë përdorimi</i>	<i>99</i>	<i>(221)</i>
<i>Efekt në aktive/detyrime të aktuarizuara</i>	<i>205</i>	<i>345</i>
(Ngarkuar)/kredituar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse	2,136	68
Totali	10,925	8,789

Norma tatimore e aplikueshme për qëllimet e llogaritjes së tatimeve të shtyra është 15% (2021: 15%).

Të gjitha lëvizjet në tatimin e shtyrë janë njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

25. Detyrime të mundshme

Procedurat ligjore. Herë pas here dhe në rrjedhën normale të biznesit, mund të pranohen pretendime kundër Kompanisë. Në bazë të vlerësimeve të veta dhe këshillave profesionale të brendshme dhe të jashtme, menaxhmenti është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet që tejkalojnë provizionet që janë bërë në këto pasqyra financiare.

Tatimet

Legjislacioni shqiptar tatimor dhe doganor, i cili është miratuar ose në thelb i miratuar në fund të periudhës raportuese, është subjekt i interpretimeve të ndryshme kur zbatohet për transaksionet dhe aktivitetet e Grupit. Rrjedhimisht, pozicionet tatimore të marra nga menaxhmenti dhe dokumentacioni formal që mbështet pozicionet tatimore mund të sfidohen nga autoritetet tatimore. Administrata tatimore shqiptare po forcohet gradualisht, duke përfshirë edhe faktin se ka një rrezik më të lartë të rishikimit të transaksioneve tatimore pa një qëllim të qartë biznesi ose me palë të papajtueshme tatimore. Periudhat fiskale mbeten të hapura për rishikim nga autoritetet në lidhje me tatimet për dy vite kalendarike që i paraprijnë vitit kur u mor vendimi për rishikimin. Në rrethana të caktuara, rishikimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Legjislacioni shqiptar i transferimit të çmimit të (TP) është përgjithësisht i përafëruar me parimet ndërkombëtare të TP-së të zhvilluara nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), megjithëse ka karakteristika specifike. Legjislacioni i TP-së parashikon mundësinë e një vlerësimi shtesë tatimor për transaksionet e kontrolluara (transaksione ndërmjet palëve të lidhura dhe transaksione të caktuara ndërmjet palëve të palidhura) nëse transaksione të tilla nuk janë të bazuara në parimin e "arm's length". Menaxhmenti ka zbatuar kontrole të brendshme në përputhje me legjislacionin aktual të TP.

Detyrimet tatimore që rrjedhin nga transaksionet e kontrolluara përcaktohen në bazë të çmimeve të transaksioneve të tyre aktuale. Me evolucionin e interpretimit të rregullave të TP-së, është e mundur, që çmime të tilla të mund të sfidohen. Ndikimi i ndonjë sfide të tillë nuk mund të vlerësohet me besueshmëri; Megjithatë, mund të jetë i rëndësishëm për pozicionin financiar dhe/ose operacionet e Grupit.

Menaxhmenti nuk ka vlerësuar ndonjë rrezik në lidhje me TP deri më 31 dhjetor 2022.

Një çështje gjyqësore e iniciuar nga Zyra e Tatimpaguesve të Mëdhenj/Drejtoria Rajonale e Tatimeve lidhet me Njoftimin për Vlerësimin Tatimor nr. 8679 / 4 të datës 19.08.2013 të lëshuar nga e njëjta zyrë dhe Drejtoria e Apelit Tatimor ("DAT") Vendimi nr. 16700/2 datë 18.12.2013.

Shoqëria u thirr në këtë proces gjyqësor për të marrë pjesë në cilësinë e palës së tretë të interesuar në këtë proces gjyqësor. I pandehuri është DAT. Kërkesa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve ka të bëjë me detyrimet e TVSH-së të vendosura nga e njëjta zyrë në Njoftimin e tyre të Vlerësimit të Taksave të përmendur më lart, e cila më pas ishte refuzuar me Vendimin DAT të përmendur gjithashtu më lart. Detyrimet e TVSH-së u ngarkuan për dështimin e Shoqërisë në lëshimin e faturës tatimore dhe pagimin e TVSH-së gjatë vitit 2010 dhe 2011 për mallrat që i nënshtroheshin tërheqjes nga tregu dhe më pas shkatërrimit.

Gjykata Administrative e shkallës së parë kundërshtoi padinë e Drejtorisë Rajonale të Taksave e cila ka paraqitur një ankesë që pritet të mbahet në vitin 2021.

Shuma për të cilën Shoqëria mund të jetë përgjegjëse në rast të një vendimi të pafavorshëm është 37,094 mijë Lekë. Për shkak të vendimit të favorshëm të gjykatës së shkallës së parë, drejtimi i Shoqërisë konsideron se nuk është e mundshme që do të kërkohet një rrjedhje e përfitimeve ekonomike si rezultat i kësaj çështje dhe për këtë arsye nuk ngriti një provizion në pasqyrat e tij financiare.

Policat e Sigurimit. Shoqëria zotëron polica sigurimi në lidhje më aktivet e saj, operacionet, punonjësit ose rreziqe të tjera të sigurueshme.

Çështje ligjore. Në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë aktualisht nuk ka çështje ligjore, ose pretendime të tjera të papaguara, të cilat mund të kenë një efekt material mbi rezultatin e operativ ose pozicionin financiar të Shoqërisë dhe të cilat nuk janë përllëgaritur ose paraqitur në këto pasqyra financiare.

PHILIP MORRIS ALBANIA SH.P.K.**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2022**

(Shumat janë shprehur në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

25. Detyrime të mundshme (vazhdim)

Garancitë bankare. Bazuar ne Ligjin e akcizës nr. 61/2012 që ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2012, e cila lejon pagesën e shtyrë të akcizës me kusht depozitimin e një garancie bankare të vlefshme pranë autoriteteve doganore, që nga 24 shtator 2012 një marrëveshje është nënshkruar mes Philip Morris Albania Sh.p.k dhe Intesa SanPaolo Bank Albania. Shuma e marrëveshjes është 3,200 milion lekë (2021: 2,800 milion lekë) me një komision prej 0.38% p.a. Kjo marrëveshje është shtyrë deri në 20 tetor 2023 dhe është subjekt i rishikimeve dhe rinovimeve vjetore. Një linjë kredie në vlerë prej 100 milionë lekë (2021: 100 milionë lekë) është në dispozicion me Intesa San Paolo Bank Albania me normë të veçantë të interesit në indeksin e bonove të thesarit 6-mujore plus 100 bps, e cila nuk është përdorur gjatë vitit 2022. Shoqëria rinovon kredinë çdo vit, marrëveshja aktuale skadon në tetor 2023.

26. Transaksionet me palët e lidhura**Transaksione dhe balanca me shoqëri të lidhura**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, Shoqëria zotërohej plotësisht nga Philip Morris S.A. Switzerland, e cila zotërohet nga Philip Morris International Inc. Transaksionet dhe balancat me shoqëritë e lidhura, të gjitha shoqëri anëtare të Philip Morris International Inc., janë si më poshtë:

31 dhjetor 2022	Shoqëria mëmë	Palë të lidhura	Totali
Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	-	-	-
Llogari dhe të tjera të pagueshme	-	963,016	963,016
31 dhjetor 2022	Shoqëria mëmë	Palë të lidhura	Totali
Blerje produktesh	-	4,386,771	4,386,771
Blerje shërbimesh	-	173,070	173,070
Të ardhura të tjera	-	-	-
31 dhjetor 2021	Shoqëria mëmë	Palë të lidhura	Totali
Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	-	155,667	155,667
Llogari dhe të tjera të pagueshme	-	789,672	789,672
31 dhjetor 2021	Shoqëria mëmë	Palë të lidhura	Totali
Blerje produktesh	-	3,480,872	3,480,872
Blerje shërbimesh	-	142,748	142,748
Të ardhura të tjera	-	156,123	156,123

Kompensimi për drejtimin kryesor

Kompensim i paguar ose që duhet paguar për drejtuesit kryesorë është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Paga dhe benefite të tjera	11,442	9,255
Shpenzime transporti	1,904	1,948
Shpenzime akomodimi	721	776
Taksa hipotetike	-	(115)
Totali	14,067	11,864

27. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas periudhës së raportimit që do të kërkonin ndryshime në informacionin e këtyre pasqyrave financiare.